



INFORMACION PËR PRINDËRIT

Sistemi i semaforit për Coronën në kopshtet shtetërore të krahinës së Austrisë së Ulët (NÖ).



Të dashur prindër,

janë dy mendime që na drejtojnë në fillimin e këtij viti për kopshtin e fëmijëve: ne dëshirojmë t'ju ofrojmë sa më shumë normalitet që të jetë e mundur për fëmijët dhe ju si familje në jetën e përditshme të kopshtit, dhe njëkohësisht, të sigurojmë shëndetin e të gjithë fëmijëve dhe të rriturve në kopshtet e fëmijëve të krahinës së Austrisë së Ulët (NÖ), përmes masave parandaluese për COVID të adaptuara sipas rajonit.

Për këtë qëllim, është zhvilluar një koncept masash për kopshtet shtetërore të fëmijëve të krahinës së Austrisë së Ulët (NÖ), bazuar në "sistemin e semaforit Corona" të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit. Kjo do të thotë, që masat paraprake higjienike në kopshtin tuaj të fëmijëve, bazohen në klasifikimin e rrezikut të infeksionit në territorin tuaj të banimit.

Për masat aktuale të parandalimit të COVID në kopshtin tuaj, do të informoheni rregullisht nga personeli i kopshtit - për shëmbull në formën e letërnjoftimeve, postës elektronike, përmes prind-kopsht-messenger "Kids Fox" ose përmes këshillit të prindërve.

Në vazhdim, do të gjeni të gjitha informacionet e rëndësishme në lidhje me "sistemin e semaforit Corona" në kopshtet shtetërore të fëmijëve të krahinës së Austrisë së Ulët (NÖ). Nëse ndërkohë nuk merrni ndonjë informacion tjetër nga kopshti, kopshti juaj i fëmijëve fillon në Shtator me fazën e gjelbër të semaforit.

I uroj fëmijës tuaj një fillim të mbarë dhe shumë argëtim, duke luajtur dhe mësuar së bashku në kopshtin e fëmijëve.



J. Mikl-Leitner

Johanna Mikl-Leitner
Landeshauptfrau

Ch. Teschl-Hofmeister

Christiane Teschl-Hofmeister
Landesrätin

FUNKSIONIM NORMAL I KOPSHTIT ME MASA PARAPRAKE HIGJENIKE

Në fazën e gjelbër të semaforit, kopshti i fëmijëve do të ketë „funksionim normal me masa paraprake higjenike“.

Çdo të thotë kjo për situatën e sjelljes dhe marrjes së fëmijës nga kopshti?

- Prindërit / Kujdestarët ligjore mund t'i shoqërojnë fëmijët kur i sjellin dhe marrin nga kopshti i fëmijëve.
- „Mbaj distancën“, dhe nëse është e mundur, shmang "zonat me shumë njerëz dhe formimin e grupeve", respekto udhëzimet në hyrje të kopshtit të fëmijëve dhe në zonën e garderobës.
- Të rriturit: Dezinfektim të duarve para hyrjes në kopshtin e fëmijëve.
- Fëmijët: Larje duarsh përpara se të hynë në grupin përkatës.

Në cilin grup do të përkujdesen për fëmijën tim?

- Përkujdesi për fëmijën do të jetë si gjithmonë në grupin përkatës.
- Oferta për mësim së bashku me fëmijë nga grupe të ndryshme do të jetë e mundur.

Si do të bëhet aklimatizimi me kopshtin i fëmijës tim?

- Një person shoqëruar mund ta shoqërojë fëmijën gjatë fazës së aklimatizimit.
- Personi shoqëruar mund të qëndrojë në grupin e fëmijës me miratimin e personelit të kopshtit.

Do të këte masa të tjera paraprake në të përditshmen e kopshtit?

- Të gjithë fëmijët do të udhëzohen që të lajnë duart rregullisht dhe shumë mirë.
- Ajrosja e ambjenteve do të bëhet rregullisht.
- Enët, peshqirët, gotat e pirjes, biberonët, etj. nuk do të ndahen me fëmijët e tjerë.
- Nuk është e nevojshme të sillni furça dhëmbësh.
- Sipërfaqet, si dorezat e derës dhe mbajtëse, lodrat dhe sendet për lojë do të pastrohen rregullisht.
- Do të zhvillohen gjithnjë e më shumë aktivitete në natyrë. Prandaj, ju lutemi që t'i jepni fëmijës tuaj veshje të përshtatshme për motin.

Do të zhvillohen në kopshtin e fëmijëve takim me prindër dhe festa?

- Takim me prindër, festa dhe aktivitete të ndryshme, do mund të zhvillohen edhe në ambjente të mbyllura, nëse respektohen udhëzimet: mbajeni distancën (me persona që nuk jetojnë në të njëjtën familje), vënde për t'u ulur fiks, lista të pjesëmarrësve (emri, numri i telefonit).

A mund të zhvillohen takime për biseda?

- Takime për bisedime mund të zhvillohen nëse respektohen masat e higjienës (mbajtje distance, dezinfektim duarsh me të hyrë në kopshtin e fëmijëve, ajrosje rregullisht e ambjenteve).

Në fazën e verdhë të semaforit, kopshti i fëmijëve do të ketë „funksionim normal nën respektimin masave të përforcuara higjienike“.

Çfarë masash parandaluese shtesë vendosen në fazën e verdhë të semaforit?

Mbrojtja e gojës dhe e hundës (MNS) për të rritur

- Për prindërit dhe vizitorë të tjerë është e detyrueshme mbajtja e maskes (MNS) nëse futen në ambientet e mbyllura të kopshtit (p.sh. nëse futen në kopshtin e fëmijëve gjatë sjelljes dhe marrjes së fëmijëve ose gjatë takimeve për biseda).
- Për personelin e kopshtit është e detyrueshme mbajtja e maskës (MNS) në ambientet e perbashketa të mbyllura, si p.sh. në korridor, në shkallë, në kuzhinë, etj. Në kontakt me fëmijët, personeli i kopshtit nuk ka detyrim për mbajtje maske (MNS).
- Fëmijët e kopshtit janë të përjashtuar nga detyrimi i mbajtjes së maskës (MNS).

Mundësisht shmangni lëvizjen nga një grup tek tjetri

- Përkujdesi për fëmijët, si deri tani, do të jetë në grupin e tyre përkatës thelbësor - puna ndër-grupore në ambiente të mbyllura, kryhet vetëm nëse është nevojë organizative ose pedagogjike (p.sh. vend mësimor për fëmijët në vitin e kopshtit të detyrueshëm, ndihmë për gjuhën, bashkim grupesh në mëngjes ose pasdite).

FUNKSIONIM NORMAL I KOPSHTIT ME MASA TË PËRFORCUARA HIGJENIKE

Takim me prindër, festa dhe aktivitete

- Në ambiente të mbyllura: me maskë (MNS), në rast se dikush nuk është i ulur ose nëse rregulli i distancës nuk mund të respektohet.
- Aktivitetet (p.sh. festa) do të organizohen – vetëm nëse janë pedagogjiksht të domosdoshme dhe mundësisht – të ndodhin përjashta.

Me këndue, me lëvizë

- Të kënduarit së bashku do të ofrohet kryesisht përjashta.
- Te kënduarit në ambiente të mbyllura: vetëm me grupe të vogla e duke ruajtur distancën.
- Lëvizja ka përparësi të ndodhë përjashta.



Gjatë fazës portokalli të semaforit kopshti i fëmijëve „do të udhëhiqet dhe funksionojë duke patur masa mbrojtëse të rritura“.

Çfare masash mbrojtëse shtesë do të zbatohen gjatë fazës portokalli të semaforit?

Sjellja dhe marrja nga kopshti

- Fëmijët do të priten dhe dorëzohen nga personeli i kopshtit të fëmijëve në hyrje të kopshtit.
- Hyrja në ambientet e mbyllura të kopshtit nga prindërit ose personat e autorizuar për të marre fëmijët, lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme (p.sh. gjatë aklimatizimit të fëmijës), por vetëm me lejen e personelit të kopshtit të fëmijëve.

Përkujdesje në grupe të vogla

- Përkujdesi për fëmijët mundësisht do të jetë në grupe të vogla – dhe nuk do të ketë orë mësimi duke bashkuar grupet.

Me këndue, me lëvizë

- Ushtrime sportive dhe aktivitete me lëvizje, që shpejtojnë frymëmarrjen tek fëmijët, ashtu si dhe të kënduarit, do të ofrohen dhe ndodhin vetëm përjashta.

FUNKSIONIM I KOPSHTIT ME MASA MBROJTËSE TË RRITURA

Bisedë me prindrit

- do të bëhen, nëse është e mundur, me telefon, digitalisht ose virtualisht (p.sh. "Kids-Fox").

Takime me prindër, festa, aktivitete

- do të anulohen ose shtyhen për një kohë tjetër.



Në fazën e kuqe të semaforit kopshti i fëmijëve do të funksionoj dhe punojë „me kufizime dhe duke patur masa mbrojtëse të rritura“.

Çfarë masash mbrojtëse shtesë do të zbatohen gjatë fazës së kuqe të semaforit?

Funksionim me kufizime i kopshtit të fëmijëve

- Përkujdesi është i garantuar për ata fëmijë për të cilët, prindërit / kujdestarët ligjorë nuk e kanë mundësinë e përkujdesit në shtëpi.
- Përkujdesi ofrohet pavarësisht nga lloji i punës së prindërve / kujdestarëve ligjorë ose edhe nëse ata mund të punojnë nga shtëpia. Nuk është e nevojshme të sillen vërtetim (p.sh. nga punëdhënësi).
- Përkujdesi është i garantuar edhe për fëmijët me nevojë më të madhe për ndihmë mësimore pedagogjike.

Përkujdes në grupe të vogla

- Përkujdesi do të bëhet mundësisht në grupe të vogla.



FUNKSIONIM I KOPSHTIT ME KUFIZIME DHE MASA MBROJTËSE TË RRITURA

Viti i kopshtit i detyrueshëm për fëmijë

- Lejohet mungesa e fëmijëve në vitin e kopshtit të detyrueshëm .





Çfarë duhet të bëni, kur shfaqen simptomat e sëmundjes?

Për të mbrojtur të gjithë fëmijët dhe të rriturit në familje dhe në kopshtet e fëmijëve, është e rëndësishme, që simptomat e sëmundjes të trajtohen me kujdes. Një sqarim mjekësor në rast dyshimi, sjell siguri për të gjithë.

- Nëse fëmija juaj tregon në kopshtin e fëmijëve simptoma të tilla si: temperaturë e lartë prej të paktën 37.9 gradë Celsius, gulçim, vështirësi në gëlltitje dhe / ose probleme të stomakut dhe zorrëve, ju si prind / kujdestar ligjor do të informoheni menjëherë. Juve do t'ju luteshim të merrni fëmijën tuaj nga kopshti dhe simptomat e sëmundjes që janë vëne re të sqarohen në mënyrë mjekësore. Derisa sa ju të vini dhe merrni fëmijën, përkujdesi për të do të jetë në një dhomë të veçantë, duke respektuar rregullat e higjienës dhe distancës. Njëkohësisht do të njoftohet autoriteti përgjegjës shëndetsor.
- Nëse ju, në shtëpi, vëzhgoni tek fëmija juaj simptomat e përshkruara, ju lutemi të shkoni tek mjeku për sqarim mjekësor, përpara se fëmija juaj të vijë përsëri në kopsht.

Për çfarë kanë nevojë fëmijët?

- Flisni me fëmijën tuaj se si do të jetë jeta e përditshme në kopshtin e fëmijëve. Informacionin që keni marrë nga kopshi i fëmijëve për ndryshimet që do të ndodhin, tregojani fëmijës tuaj në një formë të kuptueshme për të..
- Dëgjojeni fëmijën tuaj, mendimet, pyetjet apo shqetësimet që tregon në këtë kohë. Përpiquni që për pyetjet e tij të gjeni përgjigje të sinqerta dhe të kuptueshme për të.
- Për pyetjet dhe shqetësimet që keni, drejtojeni personelit të kopshtit të fëmijëve.

Së bashku, me mbështetjen tuaj, do të bëjmë të mundur, që të gjithë të qëndrojmë të shëndetshëm dhe që fëmijët në kopsht të luajnë dhe mësojnë me njëri tjetrin në kushte mundësisht sa më "normale".

